



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor TM2 2019



BRUTO PRODUKTI VENDOR TREMUJORE -TM2 2019

Agjencia e Statistikave te Kosovës (ASK) ka publikuar “Bruto Produktin Vendor” (BPV) për tremujorin e dytë 2019 sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante.

BPV në TM2 të vitit 2019 shënon rritje reale për 4.13 % në krahasim me TM2 të vitit 2018. Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon:

Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 22.4%, Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 8.95%,Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 8.8%, ndërtimtaria 6.9%, Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit 6.7%, nga të cilat: Industria përpunuese 10.6%, Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor 6.5%, Aktivitete të pasurive të paluajtshme 3.6%; ndërsa rënie reale kishte në të dhënat; Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale -1.1%, Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi -0.3%.

BPV sipas qasjes së shpenzimeve ka pasur rritje në; eksporti i mallrave dhe shërbimeve 14.3%, Formimi i bruto kapitalit me 4.1%, shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe Institucionet jo përfituese në shërbim të ekonomive shtëpiake (IJPSHESH) 0.1%.

Ndërsa rënie reale kishte në të dhënat: shpenzimet e konsumit final të qeverisë -3.2%, importi i mallrave dhe shërbimeve -0.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Për me shumë kliko ne ueb faqen e ASK : <http://ask.rks-gov.net/>

Publikimin e përgatitën:

Fatmir Morina - drejtor i departamentit

Xhevdie Fetahu - shefe e divizionit

Ylli Shala - zyrtar i lartë

Nysret Sylejmani - zyrtar

Ilir Mazrekaj - zyrtar

Emine Bajrami - zyrtare

Florijs Krapit - zyrtare

Besim Mehmeti - zyrtar

Kaltrina Veselaj - zyrtare

Prishtinë, Tetor 2019

Kryeshef i ASK-së
Isa Krasniqi


T.01- Bruto Produkti Vendor tremujor

(në milion Euro)

Tremujorët	2018				2019	
	I	II	III	IV	I	II
BPV me çmime aktuale	1,347	1,719	1,870	1,790	1,421	1,824
BPV me çmime të vitit paraprak	1,334	1,701	1,878	1,746	1,404	1,790
Rritja reale në % *	2.9	4.4	3.7	4.1	4.2	4.1

* Me periudhen përkatëse të vitit paraprak

Grafiku 1. Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak



T.02-Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike me çmime aktuale, në baza tremujore

(Në mijë euro)

Nace Rev.2		Tremujorët				Viti	Tremujorët	
		2018					2018	2019
		I	II	III	IV	I*		II*
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	91,633	136,851	109,526	143,987	481,997	95,477	145,108
B,C,D and E	Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit	245,809	310,088	322,790	308,672	1,187,359	243,768	328,730
C	<i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i>	120,770	199,506	220,153	221,115	761,545	124,826	220,230
F	Ndërtimtaria	88,853	183,168	167,673	145,258	584,952	101,601	203,442
G,H and I	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	217,882	287,224	393,854	330,623	1,229,583	225,267	311,380
J	Informacioni dhe komunikacioni	23,568	24,429	38,524	38,542	125,063	24,740	25,491
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	55,202	57,242	64,690	60,683	237,817	63,209	70,463
L	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	121,256	125,735	126,606	126,532	500,128	121,104	128,639
M and N	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	37,135	29,853	34,220	43,808	145,016	37,332	32,481
O,P, and Q	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	211,361	230,071	219,529	240,790	901,751	223,956	233,080
R,S,T and U	Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera	9,598	10,290	10,589	10,217	40,693	9,901	11,287
Bruto vlera e shtuar		1,102,297	1,394,950	1,488,002	1,449,112	5,434,360	1,146,355	1,490,101
<i>Taksat neto në produkte</i>		<i>245,051</i>	<i>324,305</i>	<i>381,709</i>	<i>340,664</i>	<i>1,291,729</i>	<i>274,959</i>	<i>333,863</i>
Bruto Produkti Vendor		1,347,347	1,719,255	1,869,711	1,789,776	6,726,089	1,421,314	1,823,963

T.03-Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime të vitit paraprak,në baza tremujore
(Në mijë euro)

Nace Rev.2		Tremujorët				Viti	Tremujorët	
		2018					2018	2019
		I	II	III	IV	I*		II*
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	101,670	161,425	117,882	142,899	523,877	91,426	136,429
B,C,D and E	Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit	229,305	293,531	334,856	295,956	1,153,648	240,639	330,761
C	<i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i>	107,491	180,291	234,390	207,682	729,855	123,194	220,655
F	Ndërtimtaria	82,058	175,898	170,005	133,096	561,057	100,284	195,716
G,H and I	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	217,452	274,521	383,718	317,000	1,192,691	223,226	305,980
J	Informacioni dhe komunikacioni	23,897	24,335	37,860	35,710	121,803	24,272	24,962
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	52,878	55,795	62,018	61,954	232,645	60,799	70,057
L	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	120,871	125,426	125,987	130,351	502,635	121,520	130,287
M and N	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	40,797	30,347	33,963	38,506	143,613	37,652	32,525
O,P, and Q	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	213,731	229,647	220,206	237,685	901,269	212,344	227,497
R,S,T and U	Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera	8,853	9,746	11,481	10,091	40,171	9,759	11,192
Bruto vlera e shtuar		1,091,514	1,380,671	1,497,977	1,403,247	5,373,408	1,121,921	1,465,406
<i>Taksat neto në produkte</i>		<i>242,120</i>	<i>320,719</i>	<i>379,665</i>	<i>342,715</i>	<i>1,285,220</i>	<i>282,501</i>	<i>324,884</i>
Bruto Produkti Vendor		1,333,634	1,701,390	1,877,642	1,745,961	6,658,628	1,404,421	1,790,290
Rritja reale e BPV-së (%)		2.88	4.36	3.75	4.08	3.82	4.24	4.13

T.04-Rritja e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak)

(%)

Nace Rev.2		Tremujorët				Tremujorët	
		2018				2019	
		I	II	III	IV	I*	II*
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	(11.17)	(11.04)	(10.09)	(10.19)	(0.23)	(0.31)
B,C,D and E	Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit	4.26	1.09	(0.39)	5.79	(2.10)	6.67
C	<i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i>	7.24	2.49	1.38	7.71	2.01	10.60
F	Ndërtimtaria	(2.56)	9.70	18.67	5.92	12.86	6.85
G,H and I	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	5.78	8.21	4.35	8.29	2.45	6.53
J	Informacioni dhe komunikacioni	8.57	4.71	1.86	6.85	2.99	2.18
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	17.78	20.91	13.61	19.82	10.14	22.39
L	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	2.63	2.86	3.47	2.19	0.22	3.62
M and N	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	2.39	1.56	1.45	6.60	1.39	8.95
O,P, and Q	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	5.84	11.03	6.97	6.93	0.47	(1.12)
R,S,T and U	Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera	2.55	4.82	0.50	0.51	1.68	8.76
Bruto vlera e shtuar		3.04	4.34	3.85	4.85	1.78	5.05
<i>Taksat neto në produkte</i>		<i>2.16</i>	<i>4.44</i>	<i>3.36</i>	<i>1.07</i>	<i>15.28</i>	<i>0.18</i>
Bruto Produkti Vendor		2.88	4.36	3.75	4.08	4.24	4.13

T.05-BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime aktuale

(Në mijë euro)

Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve		Tremujorët				Viti	Tremujorët	
		2018				2018	2019	
		I	II	III	IV		I*	II*
1=(2+3)	Shpenzimet e konsumit final	1.481.891	1.752.404	1.533.882	1.935.799	6.703.975	1.560.439	1.800.374
2	Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH	1.266.797	1.509.151	1.321.856	1.663.092	5.760.897	1.331.961	1.558.832
3	Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	215.094	243.252	212.025	272.707	943.078	228.478	241.543
4	Formimi i bruto kapitalit	327.537	600.847	546.203	507.841	1.982.429	364.924	632.121
5=(6-9)	Exporti neto	(462.081)	(633.996)	(210.374)	(653.863)	(1.960.315)	(504.050)	(608.532)
6=(7+8)	Exporti i mallrave dhe shërbimeve	270.377	337.730	849.405	320.246	1.777.757	286.102	380.911
7	Exporti i mallrave	75.408	97.429	98.656	104.341	375.834	78.478	104.053
8	Exporti i shërbimeve	194.968	240.301	750.749	215.905	1.401.923	207.624	276.858
9=(10+11)	Importi i mallrave dhe shërbimeve	732.458	971.727	1.059.779	974.109	3.738.072	790.152	989.443
10	Importi i mallrave	611.014	825.121	848.499	822.093	3.106.728	657.216	826.984
11	Importi i shërbimeve	121.443	146.606	211.279	152.016	631.344	132.936	162.459
12=(1+4+5)	BPV-ja totale me çmime aktuale	1.347.347	1.719.255	1.869.711	1.789.776	6.726.089	1.421.314	1.823.963

T.06-BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime të vitit paraprak

(Në mijë euro)

Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve		Tremujorët				Viti	Tremujorët	
		2018				2018	2019	
		I	II	III	IV		I*	II*
1=(2+3)	Shpenzimet e konsumit final	1.456.072	1.728.519	1.525.090	1.880.492	6.590.172	1.524.793	1.745.785
2	Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH	1.237.608	1.487.328	1.312.276	1.613.397	5.650.609	1.308.505	1.510.428
3	Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	218.463	241.190	212.814	267.095	939.563	216.288	235.357
4	Formimi i bruto kapitalit	316.620	587.719	584.055	478.463	1.966.856	372.422	625.665
5=(6-9)	Exporti neto	(439.057)	(614.847)	(231.503)	(612.993)	(1.898.401)	(492.794)	(581.160)
6=(7+8)	Exporti i mallrave dhe shërbimeve	282.204	346.268	815.519	330.573	1.774.564	288.330	386.186
7	Exporti i mallrave	75.527	96.434	96.673	102.152	370.786	78.147	103.171
8	Exporti i shërbimeve	206.678	249.833	718.846	228.421	1.403.778	210.184	283.015
9=(10+11)	Importi i mallrave dhe shërbimeve	721.261	961.115	1.047.021	943.566	3.672.964	781.125	967.347
10	Importi i mallrave	605.714	810.600	827.000	784.495	3.027.809	645.406	801.425
11	Importi i shërbimeve	115.547	150.515	220.022	159.071	645.156	135.719	165.922
12=(1+4+5)	BPV-ja me çmime të vitit paraprak	1.333.634	1.701.390	1.877.642	1.745.961	6.658.628	1.404.421	1.790.290

T.07-Rritja e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak)

(%)

Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve	Tremujorët				Tremujorët	
	2018				2019	
	I	II	III	IV	I*	II*
Shpenzimet e konsumit final	3,23	5,80	8,90	3,92	2,90	-0,38
<i>Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH</i>	1,63	4,85	9,89	3,34	3,29	0,08
<i>Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë</i>	13,39	12,03	3,18	7,52	0,56	-3,25
Formimi i bruto kapitalit	1,12	6,99	18,54	2,99	13,70	4,13
Exporti neto	2,75	11,23	178,14	2,72	6,65	-8,33
<i>Exporti i mallrave dhe shërbimeve</i>	20,30	15,23	-6,81	10,50	6,64	14,35
<i>Exporti i mallrave</i>	-1,21	-5,72	-8,63	8,85	3,63	5,89
<i>Exporti i shërbimeve</i>	30,71	26,04	-6,56	11,26	7,80	17,78
<i>Importi i mallrave dhe shërbimeve</i>	8,97	12,64	9,26	5,32	6,64	-0,45
<i>Importi i mallrave</i>	6,73	10,24	7,95	1,40	5,63	-2,87
<i>Importi i shërbimeve</i>	22,41	27,57	14,48	30,17	11,75	13,18
Bruto Produkti Vendor	2,88	4,36	3,75	4,08	4,24	4,13

Shënime metodologjike

1. Mbulueshmëria

Përlllogaritjet përfshijnë të gjitha aktivitetet në bazë të koncepteve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010).

2. Burimet e të dhënave të përdorura

2.1 Burimet e të dhënave statistikore

Treguesit afatshkurtër në ASK:

- Indeksi çmimeve të prodhimit (IÇP) në baza tremujore për miniera, prodhim dhe energji elektrike, gaz dhe furnizim me ujë;
- Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK), i vlerësuar në nivelin 4 shifror të COICOP;
- Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore;
- Indeksi i çmimeve të prodhimit bujqësor;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme: importi dhe eksporti i mallrave;
- Statistikat e hotelarisë (numri i vizitorëve dhe numri i netëve) ;
- Statistikat e energjisë.
- Të dhënat nga anketa e fuqisë punëtore;

2.2 Burimet e të dhënave administrative

Burimet e të dhënave administrative mujore dhe tremujore të përdorura për vlerësimin e BPV-së tremujore janë:

- Të dhënat mujore të njësive jo-financiare të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës (të dhënat mujore lidhur me qarkullimin, pagat, kontributet për sigurime shoqërore, numri i të punësuarve, blerjet dhe shpenzimet);

- Të hyrat dhe shpenzimet e qeverisë në baza mujore;

- Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit;

- Të dhënat në baza mujore për bilancin e pagesave të elaboruar në Bankën Qendrore.

3. Metoda e vlerësimit

Llogaritë kombëtare në baza tremujore përdorin të njëjtat parime, përkufizime, dhe strukturë sikurse edhe llogaritë vjetore.

4. Paraqitja e të dhënave

Të dhënat kryesore dhe kategoritë e paraqitura janë sipas koncepteve dhe terminologjisë së harmonizuar të ESA 2010. Të dhënat sipas aktiviteteve janë paraqitur sipas Klasifikimit statistikor të Aktiviteteve Ekonomike të Bashkësisë Evropiane (NACE Rev.2).

Te dhënat ne baza tremujore janë paraqitur ne tabelat ne vijim me çmime aktuale dhe si matje e vëllimit me çmime te vitit paraprak.

5. Përkufizime dhe shpjegime

Bruto Produkti Vendor me qasjen e prodhimin është i barabartë me vlerën e shtuar sipas aktiviteteve me çmime bazë, e rritur me tatimet mbi produkte, dhe të zvogëluar për vlerën e subvencioneve në produkte. Në këtë mënyrë Bruto Produkti Vendor është i barabartë me shumën e vlerës së shtuar me çmime bazë të të gjitha njësive të prodhimit të një vendi (rezidentë) dhe tatimeve neto në produkte (tatimet minus subvencionet mbi produkte).

Vlera e shtuar me çmime bazë është e barabartë me outputin me çmimet bazë, të zvogëluar për konsumin e ndërmjetëm me çmime blerëse.

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 159 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshafi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>